40	Prizren	PRZ007	4	PRZ007/4	Sharrprodhimi	Fi.302/89	NSh "Sharrprodhimi" - Shitorja në fshatin Buçe, Dragash	Lokal	Objekt i fortë	NSh "Sharrprodhimi" - Shitorja në fshatin Buçe, Dragash – përfshin lokalin afarist prej 72 m2 (me kulturë shtëpi ndërtesë) te regjistruar në emër te NSh-së në parcelë 84-2 në Zonën Kadastrale Buçe, Komuna e Dragashit	Dragash	Buçe-fshat	1	72		€ 3,500		1		Bartet toka ne sip prej 72m2. Informatë e rëndësishme: Gjatë vizitës në terren është vërtetuar se objekti dhe parcelat pjesë e shitjes së kësaj njësie sipas gjendjes faktike në terren është si në vijim: • Objekti është ndërtim i fort dhe ka etazhitet (P+0 • Janë bërë matjet interne nga AKP me shirit metër e i bar ti to objektit ku si rezultat i kësaj matje kemi sipërfaqen e objektit prej rreth 60m2.	SHAL 55 refuzim nga Bordi, SHAL 58 refuzim nga Bordi. Refuzim me SHAL 61, Refuzim nga Bordi SHAL 62.

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-184/6

Në bazë të neneve 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, nenit 23 paragrafi 5 i Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit-ZKA, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 31 korrik 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Miratohen Planet e Veprimit të AKP-së për adresimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit për pasqyrat financiare për Buxhetin e AKP-së dhe Fondet në Mirëbesim.**

II. **Ky vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi ka shqyrtuar dokumentet e përgatitura nga Menaxhmenti lidhur me Planet e Veprimit të AKP-së për adresimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit për pasqyrat financiare për Buxhetin e AKP-së dhe Fondet në Mirëbesim.

Zyra Kombëtare e Auditimit - ZKA ka përfunduar auditimin e pasqyrave financiare për vitin 2022 për Buxhetin e AKP-së dhe Fondeve në Mirëbesim

Duke u bazuar në legjislacionin në fuqi dhe obligimet që dalin nga aty për përmbushjen e të gjeturave nga auditimi, Bordi ka shqyrtuar Planin Veprimit te AKP-se për zbatimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit në Raportin e Auditimit për pasqyrat financiare për Buxhetin e AKP-së dhe Fondet në Mirëbesim.

Duke marr parasysh të gjitha më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 31 korrik 2023.

Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. Ref. BD-184/7

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 31 korrik 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet propozimi i Njësisë për Negocim Direkt.

II. Miratohet ndryshimi i vendimit të Bordit të Drejtorëve Nr. Ref. BD-124/19 datës 31.10.2019, ashtu që në vend të parashtruesit , si palë në procesin e negocimit do të jetë subjekti juridik me seli në Mitrovicë.

III. Precizohen sipërfaqja e parcelave të cilat janë objekt i kërkesës për blerje direkte dhe atë si në vijim:

- Parcela kadastrale Nr.02618-1, me sipërfaqe të përgjithshme 3250 m2

- Parcela kadastrale Nr.02618-2, me sipërfaqe të përgjithshme 742 m2

- Parcela kadastrale Nr. 02634-3, me sipërfaqe të përgjithshme 760 m2.

IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi Raportin Rekomandues- Plotësues të Njësisë për Negocim Direkt, sipas të cilit parashtruesi i kërkesës, përmes procesit te privatizimit me tender, i kishte blerë objektet ekzistuese, të cilat kanë qenë të ngritura në pjesët përkatëse të parcelave të cilat në kohen e privatizimit janë evidentuar ne emër te Komunës së Mitrovicës. Ndërkohë, me Vendimin e Agjencisë Kadastrale te Kosovës, të datës 02.06.2016, këto parcela janë evidentuar sërish ne emër te NSH "Betonjerka" në Mitrovicë. Bordi i Drejtorëve, me Vendimin Nr. BD-124/19, të datës 31.10.2019, e kishte miratuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës pwr negocim direkt. Mirëpo nga data e miratimit të Vendimit të cituar si më sipër të Bordit të Drejtorëve (2019) e deri tani kanë ndodhur disa ndryshime lidhur me precizimin e legjitimitetit të palës dhe precizimin e kërkesës. Pasi që parashtruesi ' ja ka dhuruar entitetit afarist objektet, të cilat i ka blerë nga AKP me tenderim publik. Dhe po ashtu ka vendosur që në procesin e privatizimit të parcelave lëndore, përmes negocimit eventual, të paraqitet në të ardhmen si palë subjekti juridik

Nga ana tjetër, eksperti kadastral i AKP-së (duke i analizuar shkresat e lëndës) ka konstatuar se mes parcelës 2618-1 dhe 2618-2, gjendet një GYP-Tubacion Industrial, i cili i takon Fabrikës së Zinkut në Zveçan, d.m.th. aset në pronësi publike dhe si tillë është jashtë qarkullimit juridik. Për ketë arsye eksperti kadastral i AKP-së ka rekomanduar që sipërfaqja tokësore të cilën ky Tubacion e përfshinë, duhet të përjashtohet nga procesi i privatizimit. Për ketë arsye me 06.06.2023, AKP ka dhënë pëlqimin Drejtorinë e Kadastrit në Mitrovicë, për harmonizimin e të dhënave tekstuale me ata grafike. Mirëpo, pas këtyre korrigjimeve, është dashur të bëhet edhe përmirësimi, respektivisht Plotësimi i Raportit të Vlerësuesit të palujtshmerive, datës 22.03.2021 sipas

MH.

të cilit sipërfaqja tokësore objekt i privatizimit eventual me negocim, është zvogëluar për 384 m2 (aq sa përfshinë tubacioni) nga sipërfaqja e përgjithshme e parcelës 2618/1 dhe 2618-2.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 31 korrik 2023.

Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-184/8

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 31 korrik 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet rekomandimi i Njësisë për Negocim Direkt për inicimin e shkallës më të lartë të vlerësimit bazuar në rregulloren në fuqi për rastin sipas vendimit të Bordit. Nr.ref. BD-184-7 të datë 31 korrik 2023.**

II. **Autorizohet Menaxhmenti i AKP-së që të filloj procedurën për inicimin e vlerësimit në shkallë më të lartë lidhur me Raportin e Vlerësimit të dorëzuara në AKP nga vlerësuesi i licencuar i paluajtshmërive për asetet – ngastrat kadastrale në pronësi të NSH "Betonjerka" në Mitrovicë.**

III. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi rekomandimin e Njësisë për Negocim Direkt për inicimin e shkallës më të lartë të vlerësimit bazuar në rregulloren në fuqi.

Agjencia ka pranuar vlerësime për pronat të cilat kanë qenë të aprovuara nga Bordi i Drejtorëve që t'i nënshtrohen procesit të shitjes me negocim direkt, dhe për të cilat për shkak të rrethanave objektive duke përfshirë pandeminë globale si dhe për shkak të pezullimit te punës te NJND-së, raportet përfundimtare, pjesë e të cilave janë edhe vlerësimet nuk janë proceduar tutje në Bordin e Drejtorëve për vendosje përfundimtare.
Sipas Rregullores Nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore (tutje cituar si " Rregullore") Neni 4.2 " *Me rastin e caktimit të vlerës së asetit , Agjencia i referohet " vlerës së drejtë" të asetit si bazë e vlerësimit, e paraparë me Standarde Evropiane të Vlerësimit (SEV 2020) e cila është në harmoni me procesin e shitjes direkte, natyrën dhe përmbajtjen e tij.*"

Për më tepër Neni 5.5 te Rregullores parasheh si në vijim: "*Secila nga palët (Agjencia apo parashtruesi), ka te drejte që të kërkojë plotësimin e ekspertizës fillestare ose ekspertizës në instancë të dytë, nëse konsiderohet se të dhënat janë te mangëta, ose nuk përputhen apo shprehet ndonjë dilemë eventuale lidhur me përshkrimin, saktësinë, vlerën ose për konstatime te tjera ne njërën nga ato*".

Njeri nga standardet i cili duhet te merret për bazë gjatë procesit të vlerësimit të pronës te përcaktuar me Standarde Evropiane të Vlerësimit (SEV 2020), është edhe përshtatja e vlerës së pronës.

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
ëëë.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

MA.

Raporti i vlerësimi përmban datën 22 mars 2021, dhe sipas përmbajtjes së tij, vlerësuesi ka theksuar se vlefshmëria e tij është 12 muaj, andaj edhe Njësia për Negocim Direkt ka konsideruar se është adekuate të bëhet inicimi i procedurës për ekspertizën e dytë në rastit konkret.

Ky rast ndërlidhet me vendimin e Bordit. Nr.ref. BD-184-7 të datë 31 korrik 2023, me anë të cilit miratohet ndryshimi i vendimit të Bordit të Drejtorëve Nr. Ref. BD-124/19 datës 31.10.2019, ashtu që në vend të parashtruesit ' si palë në procesin e negocimit do të jetë subjekti juridik me seli në Mitrovicë dhe II. Precizohet sipërfaqja e parcelave të cilat janë objekt i kërkesës për blerje direkte.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 31 korrik 2023

Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
ëëë.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-184/9

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 31 korrik 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Refuzohet Inicimi i procedurës për shitje me negocim direkt, Parcelën kadastrale 964-2 me sipërfaqe 593 m2 Zk Lubizhdë Komuna Prizren, Parcelën kadastrale 980-1 me sipërfaqe 4029 m2 Zk Lubizhde Komuna Prizren, Parcelën kadastrale 1002-2 me sipërfaqe 979 m2 Zk Lubizhdë Komuna Prizren, Sipërfaqen tokësore prej 437 m2 si pjesë e parcelës kadastrale 980-2 me sipërfaqe të përgjithshme 1091 m2 Zk Lubizhdë Komuna Prizren, Sipërfaqen tokësore prej 125 m2 si pjesë e parcelës kadastrale 972-5 me sipërfaqe të përgjithshme 890 m2 Zk Lubizhdë Komuna Prizren, me parashtruesit "**

II. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

III.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi Raportin Rekomandues të Njësisë për Negocim Direkt (NND), në të cilin rekomandohet refuzimi i inicimit tw procedurës për shitje me negocim direkt, Parcelën kadastrale 964-2 me sipërfaqe 593 m2 Zk Lubizhdë Komuna Prizren, Parcelën kadastrale 980-1 me sipërfaqe 4029 m2 Zk Lubizhde Komuna Prizren, Parcelën kadastrale 1002-2 me sipërfaqe 979 m2 Zk Lubizhdë Komuna Prizren, Sipërfaqen tokësore prej 437 m2 si pjesë e parcelës kadastrale 980-2 me sipërfaqe të përgjithshme 1091 m2 Zk Lubizhdë Komuna Prizren, Sipërfaqen tokësore prej 125 m2 si pjesë e parcelës kadastrale 972-5 me sipërfaqe të përgjithshme 890 m2 Zk Lubizhdë Komuna Prizren, me parashtruesit

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Në bazë të shkresave të lëndës, NND ka konstatuar se kërkesa nuk i plotëson kushtet sipas Rregullores për shitjen direkte të aseteve të caktuara të ndërmarrjeve shoqërore për faktin së në këto parcela nuk ka ndërtim, dhe prona ka qasje në rrugë. Pavarësisht fakti se prona e kërkuar kufizohet me prona private dhe sipas shkresave vërehet se parcela e NSH-së ka qasje në rrugë publike dhe mund të tenderohet.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë si dhe faktin qe rasti nuk i përmbush kriteret për blerjen e asetit ne pronësi shoqërore përmes procedurës se negocimit direkt sipas Rregullores Nr. 06/2022 Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 31 korrik 2023.

Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
ëëë.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. Ref. BD-184/10

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, në bazë të nenit 2.5 të Kontratës së Qirasë me nr. protokolli 8514/2015 në mes të NSH "Lux" dhe DP "X BAR", nenit 127 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 31 korrik 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet transferimi i kontratës së qirasë për shfrytëzimin e lokalit BALLKAN në Mitrovicë të Jugut, sipërfaqe prej 50m² nga D.P.X Bar përfaqësuar nga Hajriz Begu tek Zeqir Begu me qiranë mujore në lartësinë prej 100.00 €.**

II. **Ky vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Menaxhmenti dhe Autoritetit i Likuidimit për transfer të kontratës së qirasë së lartcekur.

Sipas vlerësimit të AL-së, transferimi i Kontratës së Qirasë do të mundësonte vazhdimin e qiradhënies pa shkëputje dhe inkasimin e sigurt të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen të ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Kjo kontratë që nga koha e lidhjes është vazhduar pa ndërprerje deri me sot, si dhe qiramarrësi ka qenë i rregullt me pagesa.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 31 korrik 2023.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO - Agjencia Kosovare e Privatizimit - Kosovska Agencija za Privatizaciju - Privatisation Agency of Kosovo - ZQ / HQ / GS - Prishtinë - Priština

Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-184/11

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, në bazë të nenit 2.5 të Kontratës së Qirasë me nr. protokolli 10489/2016 në mes të NSH "Trepca Hoteleria" dhe qiramarrësit Vida Janicijevic; nenit 127 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 31 korrik 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet transferimi i Kontratës së Qirasë për shfrytëzimin e lokalit me karakter të përkohshëm në Rr. Kralja Petra pn Mitrovicë veriore, me sipërfaqe prej 19.5 m2, me qira mujore prej 70.00 EUR.**

II. **Ky vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Menaxhmenti dhe Autoritetit i Likuidimit për transfer të kontratës së qirasë së lartcekur.

Sipas vlerësimit të AL-së, transferimi i Kontratës së Qirasë do të mundësonte vazhdimin e qiradhënies pa shkëputje dhe inkasimin e sigurt të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen të ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Kjo kontratë që nga koha e lidhjes është vazhduar pa ndërprerje deri me sot, si dhe qiramarrësi ka qenë i rregullt me pagesa.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 31 korrik 2023.

Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
ëëë.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. Ref. BD-184/12

Në bazë të nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 31 korrik 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet qiradhënia e depos së prodhimeve të gatshme te Fabrika e Telit pronë e NSh "Metaliku" bazuar në listën e bashkangjitur për qiradhënie.**

II. **Ky vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Menaxhmenti për shqyrtimi e raportit të komisionit për vlerësimin e ofertave për dhënien me qira të asetit të NSH "Metaliku" në Gjakovë.

Agjencia Kosovare e Privatizimit me datë 04 korrik 2023 ka bërë shpalljen publike për qiradhënie të asetit depo e prodhimeve të gatshme-fabrika e telit, pronë e NSH "Metaliku" në Gjakovë. Meqenëse aseti në fjalë është tenderuar katër (4) herë, ku dy herët e para nuk është pranuar asnjë ofertë dhe herën e tretë kemi pranuar vetëm një oferte nga Rudi Metal me vlerë prej 150.00 euro, e cila ofertë është refuzuar nga Menaxhmenti i AKP-së. Më 19 korrik 2023 është pranuar oferta nga operatori ekomomik Rudi Metal, i cili ka ofertuar me çmim prej 240.00 euro, prandaj me qëllim të rritjes së të hyrave të ndërmarrjes është aprovuar qiradhënia e këtij aseti me çmim prej 240.00 euro për sipërfaqen prej 2000 m², respektivisht 0.12 euro për metër katror (2000*0.12€ / m² = 240.00 Euro).

Duke marr parasysh të gjitha më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 31 korrik 2023.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO - Agjencia Kosovare e Privatizimit - Kosovska agencija za privatizaciju - Privatisation Agency of Kosovo - ZQ / HQ / GS - Prishtinë - Priština

Meritor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Aprovimi i qiradhënies së asetit të NSH "Metaliku" Gjakovë nga Bordi i Drejtorëve

Nr	Region	Emri i NSH-së	Pershkrimi i Asetit/Prones	Sipërfaqja	Vendodhja e asetit/prones	Qiramarrësi	Data e fillimit të qirasë	Data e përfundimit	Shuma mujore e qirasë/Euro	Pagesa ne Llogari të NSH/AKP
1	Pejë	Metaliku	Depo e Prodhimeve të gatshme te Fabrika e Telit	2000 m^2	Gjakovë	Rudi Metal	01.08.2023	31.07.2024	240.00 Euro	NSH

MH.

Nr. Ref. BD-184/13

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, neni 18.1.3, neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, nenit 10, paragrafi 1.2 i Rregullores Nr. 04/2022 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore; nenit 3.13.1 i Rregullores Nr. 4/2020 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore; si dhe Udhëzuesit për lirimin e aseteve të NSH-ve nga uzurpatorët dhe shfrytëzuesit e paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 31 korrik 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të parcelave kadastrale nr. 00025-0 me sipërfaqe prej 10340 m² dhe pjesa e parcelës nr. 00027-6 me sipërfaqe prej 980 m², me sipërfaqe totale prej 11320 m² në pronësi të NShBQ "Drenica" PRN011, sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej € 1000.00 për një muaj.

II. Para lidhjes së marrëdhënies kontraktuale Qiramarrësi është i detyruar të paguajë borxhin në pajtim me nenin 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirimin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, shumën prej € 36,000.00 për periudhën e shfrytëzimit të 3 viteve të fundit të parcelës në mënyrë të paautorizuar.

III. Udhëzohet Menaxhmenti dhe Autoriteti i Likuidimit që për periudhën tjetër pra prej datës 08 Maj 2013 (kur është privatizuar KEDS) të ndjek procedurat ligjore – përmbarimin për inkasimin e qirasë.

IV. Ky vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi ka shqyrtuar propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit, sipas të cilit lidhja e kontratës së qirasë do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të NSh-së. Në pronën e lartcekur është i vendosur trafostacioni dhe objekteve përcjellëse për furnizim me energji të parkut të biznesit. Pasi që pala ka parashtruar kërkesë që të hyjë ne marrëdhënie kontraktuale të qirasë dhe aktualisht i njëjti është shfrytëzues i sipërfaqës 11320m2, është formuar komisioni dhe është përcaktuar çmimin i qirasë në shumën prej € 1000.00 për një muaj.
Në pajtim me Udhëzuesin për lirimin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, për periudhën e shfrytëzimit për 3 vitet e fundit, pala do të jetë e obliguar që para nënshkrimit të kontratës së qirasë të paguajë retroaktivisht për periudhën e shfrytëzimit prej 3 vitesh shumën totale prej € 36,000.00 (36x1000.00€ në muaj).

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.
Prishtinë, më 31 korrik 2023.

Mentor Hyseni
Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
ëëë.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-184/14

Në bazë të neneve 5.12 dhe 15.2.17 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), pas diskutimeve sipas rekomandimit të Komisionit për shqyrtimin e statusit të ndërmarrjeve të caktuara (KPS), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 31 korrik 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet Raporti Shqyrtues i Komisionit për Shqyrtimin e KPS-ve i datës 06.07.2023, lidhur me statusin juridik të ndërmarrjes: KPS/SDR-1536U/PRN208, "Stacioni i Veterinës Prishtinë".**

II. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave për Përcaktimin e Statusit të Entiteteve (KPS), ku sipas tijë bazuar në nenin 5.1.1.2, të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit nr. 04/L034, si dhe provave të dokumentuara në dosjen të lëndës kjo Ndërmarrje KPS/SDR-1536U/PRN208, "Stacioni i Veterinës Prishtinë", është themeluar me kapital shoqëror, dhe konsiderohet se është ndërmarrje shoqërore dhe përfshihet nën juridiksionin e kësaj Agjencie, sikurse parashihet në mënyrë specifike me nenin 5, të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:
Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 31 korrik 2023

Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-184/15

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), neneve 40, 41.4 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 31 korrik 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet kërkesa për shpërndarjen e përkohshme të pjesshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh "Ereniku – Prodhimtaria Primare" PEJ029 (në likuidim) nga Rajoni i Pejës.**

II. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për shpërndarjen e përkohshme të pjesshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh "Ereniku – Prodhimtaria Primare" PEJ029 (në likuidim) nga Rajoni i Pejës.

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkese dhe verifikimit të listës së ankesave në DhPGjS, po ashtu shqyrtimit të analizave përmbledhëse të të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se ekzistojnë fonde të mjaftueshme për shpërndarjen e përkohshme të pjesshme të fondeve të Likuidimit të PEJ029 NSh "Ereniku – Prodhimtaria Primare" (në Likuidim).
Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 31 korrik 2023

Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës